

FJALA E DEPUTETIT FATMIR MEDIU

E ENJTE 16 QERSHOR 2022

E nderuar kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Mendoj se, pavarësisht sa duam ta dëgjojmë njëri-tjetrin, të paktën duhet të jemi tek ajo pjesë që duhet t'i dëgjojmë ata që e ngrenë zërin fort jo vetëm për interesat e tyre, jo për mëshirë, por sepse përfaqësojnë një sektor, i cili ka 20% të prodhimit të brendshëm bruto dhe fermerët e Lushnjës dhe të Shqipërisë erdhën këtu përballë parlamentit dhe kërkuan mbështetjen tonë. Unë gjej rastin ta falënderoj kolegun tim, zotin Duka, për iniciativën që ka marrë, duke njohur dhe duke vlerësuar problemet e sektorit të bujqësisë, duke dëgjuar zërin e tyre, duke u konsultuar me fermerë dhe specialistë për të propozuar këto ndryshime ligjore.

Para se të shkoj te ndryshimet ligjore që ka përcjellë zoti Duka, dua të rendis disa vlerësime të tjera që kanë të bëjnë me TVSH-në që, po ashtu, janë në një projektligj të propozuar, sepse mendoj se gjërat janë të lidhura. Zoti Duka vlerëson bashkë me specialistët e bujqësisë se është shumë i rëndësishëm një vlerësim real për sa i përket TVSH-së në bujqësi. Së pari, gjykimi është për të shmangur falimentimin e fermerëve për shkak të taksimit të padrejtë, sepse këtë kërkuan ata përballë parlamentit: rimbursimin e TVSH-së. Ndaj, ne duhet të veprojmë sa më parë, përpara se ata të falimentojnë apo përpara se e gjithë ekonomia jonë bujqësore të ndodhet në kolaps.

Së dyti, mendoj se është e rëndësishme për faktin se duhet të shmangim formalitetin në çdo sektor, edhe në sektorin e bujqësisë, dhe të shmangim, po ashtu, konkurrimin e pandershëm të mallrave të ndryshme që hyjnë në Shqipëri pa kontroll, problem që kemi edhe ne me tregun bujqësor. Së treti, mendoj se për fuqizimin e prodhimit të brendshëm dhe të produkteve të brendshme është e rëndësishme për t'i përballur ato me të importit. Prandaj, mendoj se duhet të marrim disa masa të nevojshme dhe urgjente. Është pa kuptim që inputet bujqësore në Shqipëri para janarit ishin me TVSH zero, kurse tani është rritur TVSH-ja me 10%, në një kohë

kur të gjitha janë inpute që vijnë nga importi në një situatë tërësisht problematike dhe kostot e kësaj TVSHje, në rastin më të mirë, pa dyshim, shkojnë në kurriz të fermerëve dhe atyre që blejnë mallrat tona.

Barazimi në paketën fiskale të vitit 2020 të shkallës së TVSH-së në shitje me atë në blerje për sektorin e tregtimit dhe përpunimit të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale është i domosdoshëm, sepse aplikimi i shkallëve të ndryshme të TVSH-së, që sot është në mënyrë paradoksale 0% në hyrje dhe 20% në blerje, krijon probleme shumë të mëdha me prodhimin e brendshëm. Fermerët pikërisht për këtë arsye nuk u referohen më produkteve të brendshme, por janë të detyruar që të mos falimentojnë, të shkojnë dhe të bëhen pjesë e mallrave të importit, gjithashtu, të shikojnë edhe rrugët informale për t'u përballur me këtë situatë.

U fol këtu për subvencionimin dhe unë nuk mendoj se ne do të shpikim ndonjë gjë të re, mjafton të marrim eksperiencat më të mira, në mënyrë të veçantë të rajonit. Të gjitha bujqësitë e rajonit subvencionohen nga shteti në mënyrë të drejtpërdrejtë, pa bërë dallime, pa bërë përjashtime, por duke tentuar të formalizohen në bazë të disa marrëdhënieve, të cilat janë të domosdoshme. Është e domosdoshme që subvencionimi direkt për fermerët të bëhet në bazë të produktit që ata hedhin në treg me faturën tatimore që ata duhet të paraqesin. Kjo skemë duhet të zbatohet nga buxheti i shtetit dhe kjo skemë do të formalizonte, po ashtu, qarkullimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale dhe do të rriste edhe të ardhurat në buxhetin e shtetit.

Duke pasur në bazë faturën e shitjes, të cilën duhet ta zotërojë fermeri, ai do të ishte më i interesuar që të mos hedhë asnjë prodhim në treg pa faturë për të gjetur mbështetjen që i takon, do të mbështeste dhe do të stimulonte fermerin që prodhon produkt me standardet e tregut, që do të thotë se kjo skemë do të garantonte, në gjykimin tonë, 100% efektshmëri të fondeve publike të investuara në sektorin e bujqësisë, edhe rritje të volumit të mbledhjes së TVSH-së, garantim të tatimit të drejtë dhe një konkurrence të ndershme, rritje të konkurrueshmërisë së produkteve tona, me të cilat shpesh ne mburremi dhe themi se kemi produkte bio e të tjera, por që konkurrohen në mënyrë të pandershme nga ato që vijnë nga importi.

Ndaj, në qoftë se ne nuk do t'ua japim këtë mbështetje, kjo situatë do të vazhdojë dhe do të degradojë sektorin e bujqësisë, njëkohësisht, domosdoshmërisht balancimin gradual të importit të prodhimeve bujqësore me prodhimet vendase. Po kaloj te projektligji që propozon zoti Duka në bashkëpunim me specialistët dhe fermerët. Është normale që, me zhvillimin e vendit, të rriten edhe eksportet, të rritet edhe prodhimi bujqësor dhe unë dua njëherë e mirë që t'i lemë ato krahasimet, se u bëmë si në kohën e Enverit, kur mateshim me kohën e Zogut, tani matemi me njëri-tjetrin, me çfarë është bërë 10 vjet më parë.

Zotërinj dhe zonja, është e thjeshtë: ç'ka është e mirë silleni në një nivel tjetër, ç'ka është jo e vlefshme hiqeni, por nuk mund të justifikohet mungesa e zhvillimit apo politikat e padrejta, duke bërë krahasime me njëri-tjetrin për 9 apo 10 vjet më parë, qoftë edhe për një vit më parë. Mendoj se nuk e keni marrë detyrën për të justifikuar veten. Keni marrë detyrën për të bërë atë që është e ligjshme dhe e drejtë për interesat e qytetarëve shqiptarë. Secili në këtë shtet është përpjekur të bëjë atë që ka gjykuar se është më e mira në kohën e vet.

Nuk ka gjë më absurde që ndodh në këtë vend sesa kur përpiqemi të mendojmë se gjithmonë, gjithçka fillon nga zero. Ne jemi, vetëm ne. Ne e fillojmë sot, asgjë tjetër që ka ndodhur në këtë vend s'ka pasur vlerë, se ne jemi më të zotët! Secili ka zotësinë e vet, ka politikat e veta, të cilat janë diskutuar në këtë Parlament, kanë gjetur edhe mbështetje konsensuale, ka pasur edhe debate, por e vlefshme është që të mirën ta çojmë përpara dhe të frenojmë më të keqen, jo gjithmonë të përpiqemi të tregojmë me gisht tjetrin, në një kohë kur kemi përgjegjësi dhe duhet ta kthejmë gishtin nga vetja jonë. Në mënyrë të padiskutueshme, ne duhet të kuptojmë që nuk jemi një treg i izoluar. Edhe kur flisni për Ballkanin e Hapur, edhe kur flasim për situatën në tregun e brendshëm, duhet të kuptojmë se ç'përfitojmë realisht.

Mund të përfitojmë për momentin, por të mos harrojmë që pikërisht Serbia ka një autoritet administrativ, ka një potencial ekonomik shumë herë më të madhe se ne, dhe një nga risqet më të mëdha që mund të ndodhë është pikërisht në sektorin e bujqësisë për shkak të peshës që ata kanë, në qoftë se ne nuk do të dimë ta ndërtojmë bashkëpunimin në një marrëdhënie të drejtë, që t'u shërbejë fermerëve tanë jo vetëm për momentin, por edhe në long term. Por edhe një gjë tjetër që, gjithashtu, është e rrezikshme ndërhyrja në tregjet tona e ekonomive ruse dhe

kineze, të cilat do të kishin një kosto edhe në raport me interesa të tjera, që janë mbi atë të bujqësisë, që është momental.

Dua të kujtoj edhe një herë atë që tha sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Stoltenberg: “Nuk është biznesi dhe vetëm marrëdhënia ekonomike që përcakton atë çka është e drejtë për një vend, se mund të fitojmë ekonomikisht, por mund të humbasim liritë dhe të drejtat tona, dhe jo gjithmonë liria e tregut është barasvlershme me lirinë e qytetarëve tanë”. Unë mendoj se këto thënie nuk duhet t’i dëgjojmë vetëm si klishe, por duhet të përpiqemi t’i shikojmë sesi mund t’i zbatojmë në politikat tona ekonomike. Prandaj mendoj se është e shumë e rëndësishme që iniciativën që kemi sot përpara ta vlerësonim me ato aspekte, që ajo sjell në mbështetje të fermerëve dhe të bujqësisë.

Nuk mund të ecim me idenë që duhet të presim se do të bëhet strategjia, por nevojat janë sot. Ne do të ndeshemi në vazhdim me një problem më të madh, me atë të zinxhirit të ushqimeve, të prodhimit, të mbështetjes së prodhimit dhe në qoftë se nuk do të marrim masa të menjëhershme në mbështetjes të fermerëve me politika për zhvillimin e bujqësisë, ne mund të ndodhemi përballë situatave krejt të pakëndshme dhe të disfavorshme, të cilat nuk kanë më kosto vetëm mbi ministrin, por kanë mbi fermerët, mbi qytetarët dhe mbi të gjithë shoqërinë shqiptare.

Prandaj, propozimi që është bërë për një skemë mbështetëse, me një afat jo më pak se 5 vjet, në sektorë të caktuar të bujqësisë për mbështetjen afatgjatë të sektorëve specifikë, është një gjë logjike dhe e vlefshme, sepse asnjë investim nuk mund të kryhet sot për sot dhe nesër për nesër. Çdo investim që është afatgjatë garanton, pa dyshim, një stabilitet më të madh të investimit dhe të mundësisë për të rikthyer investime.

Mbështetja me subvencionime të drejtpërdrejta e sektorëve produktivë, do të ishte një shtytje për të rikthyer investimet dhe njëkohësisht për t’iu kthyer punës në bujqësi, që të gjithë njerëzit të shikojnë mundësinë që ky sektor të jetë 20% i prodhimit të brendshëm bruto, të jetë një sektor real, ku mund të zhvillohet ekonomia, jo më nëpër kafën, por atje ku prodhohet. Ta kthejmë ekonominë shqiptare në një ekonomi prodhuese, në një ekonomi të vlefshme. Nuk dua të zgjatem, por dua edhe një herë ta falënderoj zotin Duka, jo për shkak të raportit politik që

kemi, por për shkak të korrektesës qytetare, për të dëgjuar zërin e fermerëve shqiptarë.  
Faleminderit!